

Rruga Aleksandër Moisiu nr.78
Kinostudio
Tirana, Albania 1005
T +35542365188
F +35542365157
W www.ihrffa.net
@ info@ihrffa.net

iHRFFA
International Human Rights
Film Festival Albania

NR 212/2 PROT
Dt. 14-05-2018

Tiranë, me 10 Maj 2018
Prot Nr. 92

Drejtuar: Qendrës Kombëtare e Kinematografisë
Lënda: Kthim përgjigje

Inderuar Z. Butka,

Lidhur me përgjigjen tuaj mbi kërkesën për mbështetje financiare të Edicionit të 13 të IHRFFA 2018 po ju drejtohemë sërisht:

Pyetja jonë është, se pas shume parashtrimeve dhe argumenteve nga ana jonë me shkrim dhe me gojë madje dhe në zyrën tuaj, për një keqkuptim informimi festivalesh, nëse si kryetar i QKK dhe hartues politikash kinematografike, a jeni ju i interesuar që IHRFFA 13 të bëhet apo të dështojë?

Mbledhjet dhe bordet në QKK, si nomenklaturë, jeni ju që i organizoni.

Në një frysë bashkëpunimi, nisur edhe nga afërsia gjeografike, ju mund edhe të na kontaktonit për IHRFFA, por edhe të dërgonit një thirrje me email zyrtar për aplikim në adresën e 6 Festivaleve që mbahen çdo vit në Shqipëri. (nëse llogarisim edhe festivalin e Durrësit i cili nuk mbahet prej disa vitesh)

Sic edhe e dini, IHRFFA është krijuar fill pas TIFF dhe sot numërojmë 13 vjet të cilat dëshmojnë një festival të rëndësishëm tradite dhe jo nga fundi i listës sic figurojmë ne faqen zyrtare të QKK.

Në fakt është e dyta herë që QKK shfrytëzon një keqkuptim lajmërimi për aplikim për të përjashtuar IHRFFA nga mbështetja financiare.

Nuk do dëshiroja që sa më lart të ishte një politikë e qëllimshme përjashtuese e QKK ndaj IHRFFA, Orafilm dhe Akademisë së Filmit dhe Multimedias Marubi.

Dëshirojmë të rishikoni dhe një herë kërkesën tonë, në funksion të interesit të përbashkët.

Mendojmë se aty ku ekziston vullneti i mirë dhe argumenti i shëndoshë është dhe zgjidhja.

Unë nuk besoj se ju Z. Butka si kryetar i QKK, jeni i interesuar të mos realizohet IHRFFA sivjet.

Me respekt

Kujtim Çashku

